

## 1- SHERBIMI I TRANSPORTIT

### 1- Liçensë për transport udhëtarësh me taksi

#### Dokumente të nevojshme :

- Autorizimin e Bashkisë.
- Formular vetëdeklarimi
- Vërtetim nga Gjykata (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga Prokuroria (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga D.R.SH.T.RR për shkeljet e kryera si drejtues mjeti
- Garanci bankare (me anë të një vërtetimi që mund të jetë një garanci bankare, ose një siguracion, përfshirë një siguracion të përgjegjësive profesionale nga një ose më shumë banka ose institucione të tjera financiare, përfshirë shoqëritë e sigurimit, të cilat bëhen garant solidar për ndërmarrjen lidhur me shumën e përcaktuar)
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.
- QKB dhe ekstrakt, ku mjeti të jetë i regjistruar;
- Leja drejtimit.
- Leja e qarkullimit, për çdo mjet
- Dëshmi taksisti.
- Certifikata e kontrollit teknik për mjetin/mjetet.
- Akt-vlerësimin për kushtet e komoditetit për mjetin/ mjetet
- Polica e sigurimit (për çdo mjet dhe për pasagjerët);
- Dokumentin për verifikimin dhe pumbosjen e taksimetrit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (DKMK).
- Dokumentin e pronësive për mjetet ose (kontrata e punësimit në rast se drejtuesi i mjetit, nuk është pronar i tij);
- Vërtetim banimi, dhe certifikate familjare.
- Kopje karte identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

#### Baza ligjore :

- Ligj nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” , i ndryshuar
- Udhëzim nr. 3918, datë 18.7.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”
- Udhëzim nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”

- Udhëzim nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar

## **2- Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet**

### **Dokumente të nevojshme**

- Rregjistrimi ne Rregjistrin Tregtar, ku mjeti te jete i rregjistruar ne QKB
- Leja e qarkullimit
- Certifikata e kontrollit teknik
- Police sigurimi te pronarit dhe mjetit
- Leja e drejtimit;
- Certifikaten e tahogرافit(per mjetet mbi 3.5 ton)
- Certifikate e aftesimit profesional(per mjetet mbi 3.5ton)
- Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij);
- Vërtetim që subjekti ka likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.
- Kopje karte identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar
- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit te transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore
- Udhëzimi Nr.15, date 24.7.2007 “Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe ceritifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor”, I ndryshuar

### **3- Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.**

#### **Dokumente të nevojshëm :**

- Ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga QKB, ku te kete te regjistruar mjetin perkates .
- Certifikata e kontrollit teknik periodik te mjetit.
- Akt-vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të mjetit, për transportin e udhëtareve.
- Policen e sigurimit të mjetit dhe udhëtareve.
- Certifikaten e tahogرافit
- Vertetimi i pronësisë së mjetit ose kontrata e qerase.
- Leja e qarkullimit;
- Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij);
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet vendore.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara**

#### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar
- Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”
- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit të transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore
- Udhezimi Nr.15, date 24.7.2007 “Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe ceritifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor”, I ndryshuar me Udhezimin Nr. 5, date 17.12.2011.
- Udhezimin nr. 5627, date 18.11.2016 “Per percaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licencave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor te udhetareve brenda vendit”, i ndryshuar

## 4- License rrethqytetese

### Dokumente të nevojshëm

#### Per subjektin:

- Formular vetedeklarimi
- Vërtetim nga Gjykata (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga Prokuroria (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga D.R.SH.T.RR per shkeljet e kryera si drejtues mjeti
- Garanci bankare (me anë të një vërtetimi që mund të jetë një garanci bankare, ose një siguracion, përfshirë një siguracion të përgjegjësishë profesionale nga një ose më shumë banka ose institucione të tjera financiare, përfshirë shoqëritë e sigurimit, të cilat bëhen garant solidar për ndërmarrjen lidhur me shumatat e përcaktuara)
- Certifikate e kompetencës profesionale (për transport udhëtarësh Brenda vendit në emer të administratorit subjektiv, në të kundërt në emer të drejtuesit teknik si dhe kontratën me zyren e punës)
- QKB dhe Ekstrakt I QKB;
- Licencën e mëparshme nëse ka.
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.
- **Per mjetet:**
- Numrin e mjeteve të nevojshme me dokumentacionin përkatës të tyre si (a) Leja e qarkullimit; b) Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve; c) Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, d) Certifikata e kalibrimit të tahografit; e) Rregjistrimi I mjeteve në QKB, f) Policën e sigurimit të çdo mjeti).
- **Per drejtuesin e mjetit:**
- Leje drejtimi.
- Certifikata e aftësisë profesionale për drejtuesin e mjetit, sipas klases që kërkohej.
- Police sigurimi për pronarin/drejtuesin e mjetit dhe pasagjeret.
- Kopje kartë identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

### Baza ligjore

- Ligj nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj nr. 8308, dt. 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 5627, dt. 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar
- Udhëzim nr. 15, dt. 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar me Udhëzim nr.5, dt. 17.2.2011

## **5- Liçencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit. ( LICENSE QYTETESE)**

### **Dokumenta të nevojshëm**

#### **Per subjektin:**

- Formular vetedeklarimi
- Vërtetim nga Gjykata (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga Prokuroria (për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë);
- Vërtetim nga D.R.SH.T.RR per shkeljet e kryera si drejtues mjetei
- Garanci bankare (me anë të një vërtetimi që mund të jetë një garanci bankare, ose një siguracion, përfshirë një siguracion të përgjegjësisë profesionale nga një ose më shumë banka ose institucione të tjera financiare, përfshirë shoqëritë e sigurimit, të cilat bëhen garant solidar për ndërmarrjen lidhur me shumatat e përcaktuara)
- Certificate e kopetences profesionale(per transport udhetaresh brenda vendit ne emer te administratorit subjektit, ne te kundert ne emer te drejtuesit teknik si dhe kontraten me zyren e punes)
- QKB dhe Ekstrakt I QKB;
- Licencen e meparshme nese ka.
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.

#### **Per mjetet:**

- Numrin e mjeteve te nevojshme me dokumentacionin perkates te tyre (a)Leja e qarkullimit; b) Certificate e kontrollit teknik të mjeteve; c) Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, d)Certificate e kalibrimit të tahografit; e) Rregjistrimi I mjeteve ne QKB, f)Policen e sigurimit te cdo mjetei).

#### **Per drejtuesin e mjetit:**

- Leje drejtimi.
- Certificate e aftesise profesionale per drejtuesin e mjetit, sipas klases qe kerkohet.
- Police sigurimi per pronarin/drejtesin e mjetit dhe pasagjeret.
- Kopje karte identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar
- Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”

- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit te transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore”, i ndryshuar.
- Udhezimi Nr.15, date 24.7.2007 “Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe cerifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor”, I ndryshuar me Udhezimin Nr. 5, date 17.12.2011.
- Udhezimin nr. 5627, date 18.11.2016 “Per përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licencave dhe cerifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor te udhetareve brenda vendit,i ndryshuar

## **6- Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.( ÇERTIFIKATË QYTETËSE)**

### **Dokumente të nevojshëm**

- Ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga QKB, ku të ketë të rregjistruar mjetin përkatës.
- Çertifikata e kontrollit teknik periodik të mjetit.
- Akt-vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të mjetit, për transportin e udhëtarëve.
- Policën e sigurimit të mjetit dhe udhëtarëve.
- Çertifikatën e tahogرافit
- Vërtetimi i pronësisë së mjetit ose kontrata e qerasë.
- Leja e qarkullimit;
- Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij);
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet vendore.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar
- Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”
- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit te transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore”, i ndryshuar.
- Udhezimi Nr.15, date 24.7.2007 “Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe cerifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor”, i ndryshuar .
- Udhezimin nr. 5627, date 18.11.2016 “Per percaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licencave dhe cerifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor te udhetareve brenda vendit”, i ndryshuar.

## **7- Licencë transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumentet e nevojshëm**

- 1- Formular tip i autodeklarimit
- 2- Çertifikatë rregjistrimi në QKR
- 3- Ekstrakt historik i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit
- 4- Çertifikatë për kompetencë profesionale për transport udhëtarësh brenda vendit në emër të administratorit. (në të kundërt, në emër të drejtuesit teknik si dhe kontratën me Zyrën e Punës).
- 5- Programi vjetor ekonomik – financiar dhe plan – biznesi
- 6- Kontratat e punës me punonjësit (emrat, klasa e patentës)
- 7- Dëshmi penaliteti për administratorin
- 8- Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave, në emër të subjektit që ka shlyer detyrimet (Vetem për kërkesat që vijnë nga Njesi Administrative pa sistem SiZ1N)
- 9- Vërtetim për garanci bankare në shumën 30.000 lekë për mjetin e parë dhe 15.000 lekë për çdo mjet tjetër
- 10- Miratimi i orarit të kthimit nga bashkia e stacionit fundor
- 11- Siguracion i shëndetit të udhëtarëve

## **8- Çertifikatë transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumentet e nevojshëm**

- 1- Çertifikatë rregjistrimi në QKR
- 2- Ekstrakt historik
- 3- Çertifikatë e kontrollit teknik periodik
- 4- Leje qarkullimi
- 5- Akt vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për transportin e udhëtarëve për çdo mjet
- 6- Vërtetimi i pronësisë së automjetit ose kontrata e qerasë, kur makina merret me qera
- 7- Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që paguan sigurimet, drejtuesi i automjetit i punësuar te subjekti publik ose privat
- 8- Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave e Bashkise për shlyerjen e detyrimeve lokale për subjektin
- 9- Siguracioni i shëndetit të udhëtarëve
- 10- Çertifikata e kompetencës profesionale

## 9- Liçensë mallra për të tretë

### Titulli i shërbimit – Kërkesë për marrjen e liçencës për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit

#### Dokumenta te nevojshem per aplikim

Formulari i auto deklarimit;

- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria (për drejtuesin e veprimtarisë);
- Dokumentacionin e kredibiliteti bankar;
- Çertifikatën e kompetencës profesionale në transportin rrugor;
- Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit (QKB);
- Leja e qarkullimit (për çdo automjet);
- Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo automjet);
- Kontrata e sigurimit (për çdo automjet);
- Leja/t e drejtimit;
- Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi nuk është pronar).

*\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara*

#### Baza ligjore

Ligj nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

- Ligj nr. 8308, dt. 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (ndryshuar me ligjet nr. 8908, dt. 6.6.2002; nr. 9096, dt. 3.7.2003; nr. 9373, dt. 14.4.2005; nr. 9760, dt. 21.6.2007; nr. 10137, dt. 11.5.2009; nr. 10 302, dt. 15.7.2010; nr. 118, dt. 13.12.2012; nr. 21, dt. 14.2.2013; nr. 37, dt. 10.4.2014; nr. 10/2016, dt. 11.2.2016)
- VKM nr.194, dt. 9.3.2011 “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.325, dt. 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”
- VKM nr.325, dt. 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”
- Udhëzim nr. 15, dt. 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar me Udhëzim nr.5, dt. 17.2.2011



## **10- Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit**

**Emri i shërbimit** - Kërkesë për marrjen e certifikatës për transport mallrash për te trete dhe me qera brenda vendit

### **Dokumente të nevojshme**

- Ekstrakt QKB.
- Rregjistrimi i mjetit/mjeteve ne QKB.
- Leja e qarkullimit
- Certifikata e kontrollit teknik
- Police sigurimi te pronarit dhe mjetit
- Leja e drejtimit;
- Certifikate e aftesimit professional.
- Certifikaten e tahogرافit(per mjetet mbi 3.5 ton)
- Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij);
- Vërtetim që subjekti ka likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.
- Kopje karte identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në original ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar
- Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”
- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit te transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore”
- Udhezimi Nr.15, date 24.7.2007 “Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe ceritifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor”, I ndryshuar

## **11-AUTORIZIM TË LËVIZJES JASHTË LINJËS PA NDALESË**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumentet e nevojshme :**

- 1- Kopje te kartes se Identitetit
- 2- Lejen e drejtimit te drejtuesit te mjetit
- 3- Lejen e qarkullimit te automjetit
- 4- Dokumentin e gjendjes teknike te mjetit

## **12-LEJE QARKULLIMI**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumente te nevojshme :**

1. Kërkesë me shkrim nga subjekti që përcakton itinerarin dhe orarin e lëvizjes së mjetit
2. Çertifikatë rregjistrimi në QKR
3. Ekstrakt historik
4. Leje qarkullimi
5. Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit
6. Çertifikatë transport udhëtarësh
7. Akt vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për transportin e udhëtarëve për çdo mjet
8. Kontratë për shërbim transport punonjësish/nxënësish në qytet (lista e xënësve)
9. Siguracioni i shëndetit të udhëtarëve
10. Letër njoftim elektronik (fotokopje)

### **13- KËRKESË PER VENDPARKIM TË REZERVUAR**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

#### **Dokumente të nevojshme :**

- 1- Kërkesë me shkrim
- 2- Çertifikatë rregjistrimi në QKR
- 3- Hartë treguese
- 4- Letër njoftim elektronik (fotokopje)
- 5- Foto

### **14- Liçensë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikantë.**

#### **Dokumente të nevojshme**

- Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrimit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të saj.
- Projektin teknologjik të depove dhe të linjave, të miratuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi të mjedisit dhe të mbrojtjes nga zjarri. Projekti teknologjik për depot dhe linjat që përdoren për depozitimin dhe shitjen e gazit të lëngshëm të naftës duhet të jetë i miratuar edhe nga organet përkatëse të kontrollit të pajisjeve nën presion.
- Dokumentacioni që verteton se stacioni i shitjes së karburantit është ndertuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit ose që është në procedurë legalizimi në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës.
- Certifikatën e kalibrimit të rezervuarëve, të vendosur në stacion, dhe të matjes së aparateve të shitjes së karburanteve dhe gazit të lëngshëm të naftës, nga DPM-ja ose organet e autorizuara për këtë qëllim.
- Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin.
- Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës.
- Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore.
- Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore.
- Leternjoftim elektronik.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në original ose fotokopje të noterizuara.**

## **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8450, date 24.2.1999 “Per perpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”, i ndryshuar,
- VKM Nr. 970, date 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftes bruto dhe nënprodukteve të saj“, i ndryshuar, kreu II, pika 2, per marrjen e liçensave per funksionimin e Stacioneve te Shitjes se karburanteve.

### **15- Licence per transport ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumentat e nevojshme**

1. Formular tip i autodeklarimit
2. Çertifikatë rregjistrimi në QKR
3. Ekstrakt historik i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit
4. Çertifikatë për kompetencë profesionale për transport udhëtarësh brënda vendit në emër të administratorit.( në të kundërt, në emër të drejtuesit teknik si dhe kontratën me Zyrën e Punës).
5. Programi vjetor ekonomik – financiar dhe plan – biznesi
6. Kontratat e punës me punonjësit (emrat, klasa e patentës)
7. Dëshmi penaliteti për administratorin
8. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave, në emër të subjektit që ka shlyer detyrimet (Vetëm për kërkesat që vijnë nga Njësi Administrative pa sistem SiZ1N)
9. Vërtetim për garanci bankare në shumën 30.000 lekë për mjetin e parë dhe 15.000 lekë për çdo mjet tjetër
10. Siguracion i shëndetit të udhëtarëve
11. Miratimi i orarit të kthimit nga bashkia e stacionit fundor

## **16-Certifikatë për transport në linjë të rregullt ndërqytetesë ndërmjet qarqeve**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumente të nevojshme për dorëzim**

1. Certifikatë rregjistrimi në QKR
2. Ekstrakt historik
3. Certifikatë e kontrollit teknik periodic
4. Leje qarkullimi
5. Akt vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për transportin e udhëtarëve për çdo mjet
6. Vërtetimi i pronësisë së automjetit ose kontrata e qerasë, kur makina merret me qera
7. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që paguan sigurimet, drejtuesi i automjetit i punësuar te subjekti publik ose privat
8. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave e Bashkise për shlyerjen e detyrimeve lokale per subjektin
9. Siguracioni i shëndetit të udhëtarëve
10. Tahograf
11. Polic sigurimi
12. Certifikata e kompetences profesionale

## **16-Liçencë për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë.**

### **Dokumente të nevojshme**

- Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto dhe/ose nenprodukteve te saj.
- Projektin teknologjik të depove dhe të linjave, të miratuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi të mjedisit dhe të mbrojtjes nga zjarri. Projekti teknologjik për depot dhe linjat që përdoren për depozitimin dhe shitjen e gazit të lëngshëm të naftës duhet të jetë i miratuar edhe nga organet përkatëse të kontrollit të pajisjeve nën presion
- Dokumentacioni që verteton se stacioni i shitjes se karburantit është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit ose që është në procedure legalizimi në perputhje me legjislacionin në fuqi.

- Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës
- Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin.
- Certifikatën e kalibrimit të enëve dhe të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit.
- Autorizim hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës
- Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore.
- Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore.
- Leternjoftim elektronik.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar
- VKM Nr. 970, date 2.12.2015 „Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj“, i ndryshuar, kreu II, pika 2, për marrjen e liçensave për funksionimin e Njësive të Shitjes së Lendëve djegëse

### **17- Licence per agjenci transporti udhetaresh ne linje ndërkombetare**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

#### **Dokumentet e nevojshme për dorëzim :**

- 1- Formular tip i autodeklarimit
- 2- Dokumenti i pronësisë në emër të subjektit kërkues së bashku me hartën treguese për zyrën e agjencisë ose, kontratë qeraje
- 3- Liçencë për transport ndërkombëtarë udhëtarësh në emër të subjektit kërkues ose kontratë me një transportues ndërkombëtar udhëtarësh të liçencuar
- 4- Çertifikatë për kompetencë profesionale për transport udhëtarësh brënda vendit në emër të administratorit (në të kundërt, në emër të drejtuesit teknik si dhe kontratën me Zyrën e Punës)
- 5- Vërtetim për garanci bankare në shumën 700.000 lekë
- 6- Ekstrakt historik i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga QKR
- 7- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria për administratorin
- 8- Evidencë statistikore vjetore, sipas formularit të miratuar nga ministria (plan – biznesi)
- 9- Deklaratë për lidhjen e kontratave të punës me punonjësit (emrat, klasa e patentës)
- 10- Vërtetim nga Dega Tatimeve, në emër të subjektit që ka shlyer detyrimet
- 11- Mandat pagese (40.000 lekë)

## **17- Liçencë për agjenci transport udhëtaresh dhe shërbimi taksi brenda vendit.**

### **Dokumente të nevojshme**

- Formular vetedeklarimi
- Vertetim nga Gjykata ( për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë)
- Vertetim nga Prokuroria ( për drejtuesin/drejtuesit e veprimtarisë)
- Certifikate e kompetencës profesionale në transportin rrugor
- Esktrakt i Regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit (QKB)
- Dokumentacioni i pronësise për zyrën/zyrat e agjencisë dhe kontrata e sipërmarrjes
- Garanci bankare (me vlere 140.000 leke per mjetin e pare dhe 70.000 leke per cdo mjet tjetër)
- Numrin e mjeteve te nevojshme me dokumentacionin perkates te tyresi (a)Leja e qarkullimit; b) Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve; c) Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, Certifikata e kalibrimit të tahografit; Policen e sigurimit te cdo mjeti, rregjistrimi I te gjitha mjeteve ne QKB).
- Leje drejtimi.
- Licencen e mëparshme nese ka.
- Vërtetim që janë likuiduar detyrimet tatimore dhe vendore.
- Kopje karte identiteti.

**\*Dokumentacioni dorëzohet në original ose fotokopje të noterizuara.**

### **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”
- Ne VKM nr. 325, date 19.3.2008 “Per miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarine e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhetarëve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare të caktuara për keta operatorë
- Udhëzimi Nr.15, date 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e leshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarise në transportin rrugor”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5, date 17.12.2011.

## **18- AUTORIZIM TRANSPORT UDHETARESH ME TAKSI 8 PLUS 1 BRENDA QARKUT**

Bazuar në Udhëzimin nr. 15, datë 24. 07. 2007 (i ndryshuar), Neni 15, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

### **Dokumentet e nevojshme:**

1. Çertifikata e regjistrimit ne QKR
2. Ekstrakt historik
3. Formulari tip i autodeklarimit
4. Çertifikatë e kontrollit teknik periodic
5. Leje e qarkullimit
6. Dëshmi e aftësisë si taksist
7. Akt vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për transportin e udhëtarëve
8. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria
9. Siguracion për udhëtarët
10. Taksimetër
11. Vërtetim për garancinë bankare (30.000 lekë mjeti i parë, 15.000 çdo mjet tjetër)

## **19- Liçencë për Shërbimet e rregullta të specializuara**

Bazuar në Udhëzimin nr. 5627, datë 18. 11. 2016, Neni 9, Pika 1, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëlidhur dokumentat e mëposhtëm :

1. Kërkesa për aplikim, lidhja 6
2. Vetëdeklarimi për reputacionin e mirë të përfaqësuesit ligjor të subjektit transportues dhe drejtuesit të veprimtarisë (lidhjet 7/1, 7/2). (Neni 9, pika 1.1, germa a )
3. Çertifikata e kompetencës profesionale (CKP për drejtuesin e veprimtarisë, ose një person i punësuar me kontratë për një periudhë të paktën 5 vjeçare; (Neni 9, pika 1.1, germa c)
4. Ekstrakti (Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë QKB, ku objekti i veprimtarisë “Për transport udhëtarësh brenda vendit ( Neni 9, pika 1.1, germa d) ku te jenë të regjistruara targat e mjeteve që do të licensohen .
5. Licencë për agjensi transporti brenda vendit, ose kontratë me një agjensi transporti (Neni 9, pika 1.4)
6. Kontratë mes subjektit dhe organizatorit të transportit dhe lista e udhëtarëve. Udhëtarët duhet të jenë punonjës të ndërmarrjes ose nxënës të institucionit shkollor.(Neni 20,pika 2)
7. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për shlyerje detyrimesh, për rinovim licence listë pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të drejtuesve të mjeteve.



8. Për rinovim licence, dorëzohet Licenca origjinale e lëshuar nga Bashkia ose kopja e njehsuar me origjinalin.

#### **Dokumentacioni për drejtuesin e mjetit**

